



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2021

**VENDIM**  
Nr.28, date 23 /07/2021

**PËR**

**MBIKQYRJEN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT GJATE REHABILITIMIT TE DIGES  
SE SPITALLES E SHFRYTEZUAR NGA BASHKIA DURRES**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 20, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 28.07.2021 mori në shqyrtim dokumentacionin teknik të paraqitur nga Bashkia Durrës për Mbikqyresin e Punimeve për Reabilitimin e diges së Spitalles. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni u vërejt se firma konsulente "NOVATECH STUDIO" është caktuar për mbikqyrjen e punimeve si dhe ekspertet e saj të caktuar në ekipin e mbikqyrjes së punimeve nuk kanë licencën përkatëse për mbikqyrje të punimeve për digat e mëdha

Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur nga Bashkia Durrës si shfrytëzues i kësaj dige, si dhe mos plotesimit të kërkesave të Rregullores për Sigurinë e digave, neni 20 e miratuar me VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, KKDM në mbledhjen e datës 23.07.2021,

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratojë Mbikqyresin e Punimeve të caktuar nga Bashkia Durrës për Reabilitimin e diges së Spitalles për arsye të mungesës së kategorisë përkatëse të licencës për mbikqyrje të punimeve në digat e mëdha dhe për rrjedhojë të mosplotesimit të kërkesës së Nenit 20 të Rregullores për Sigurinë e Digave.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në përputhje me këtë Vendim dhe legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

